



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.62/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.62/2025 e datës 17.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 17.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se aktivisti dhe përkrahësi i Subjektit Politik Besian Bucaliu Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në rrjetet sociale facebook dhe tik tok, paraqitet rrejshëm si përkrahës dhe votues i Lëvizjes Vetëvendosje LVV, duke votuar nga diaspora për shumë persona, me pamjet në prapavijë Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, i cili shfaqet duke mbajtur një fjalim në njërin nga tubimet elektorale.

Sipas parashtruesit të ankesës këto veprime kanë qëllime të mashtrimit të opinionit, dëmtimin elektorale, nxitjen e urrejtjes, denigrimin dhe fyerjen ndaj Subjektit Politik LVV.

Më tej në ankesë thuhet se anëtari dhe mbështetësi Besian Bucaliu si dhe Subjekti Politik PDK, me këto veprime kanë cenuar rëndë nenin 34, paragrafi 1.11, dhe nenin 89 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovës si dhe përbëjnë dyshime të arsyeshme për shkelje penale të mashtrimit dhe vepra penale kundër të drejtave të votimit të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur një CD, me gjashtë materiale të cilat përmbajnë video dhe fotografi.

Në materialin e parë shihet që video e publikuar nga Ilmi Recica — kandidat i PDK-së për deputet, është e shkarkuar prej profilit personal në TikTok të këtij aktivisti, Besian Bacaliu. Kjo dëshmi vërtetohet prej logos (ëatermark) që platforma TikTok e krijon në momentin që shkarkohet video nga kjo platformë. Profili i këtij personi mund të gjendet në këtë link: <https://ëëë.tiktok.com/@besian.bacaliu>

Në materiali e dytë, Screenrecord i profilit të Besian Bacaliut ku lehtë shihet se ky person është aktivist/ simpatizant (militant) i PDK. Gjithashtu në këtë material shihet që postimi (materiali 1) është fshirë nga profili i tij, pas publikimit në media.

Në materialin e tretë, Screenshot i profilit të personit Besian Bacaliu në Facebook ku shihet se ky person është personi i vërtetë.

Në materialin e katërt postimi i personit në fjalë ku shihet që është përkrahës i Hashim Thacit

Në materialin e pestë postimi ku shihet ky person është kundër Albin Kurtit.

Në materialin e gjashtë, Screenshot i fotografive të publikuara në profilin e këtij personi ku shihet që ky është simpatizant i flaktë i PDK.

Përmes këtij veprimi, parashtruesi vlerëson se janë shkelur rëndë dispozitat ligjore zgjedhore të cilat kanë të bëjnë me nxitjen e urrejtjes me qëllimin e dëmtimit elektoral, siç përcaktohet në nenin 34, paragrafi 1.11 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, i cili shprehimisht thotë "*përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxitë apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë "ndikim të tillë."*, por gjithashtu, dispozitat nga neni 89, paragrafi 3 i këtij neni: "*3. Askush nuk lejohet të votojë në emër të një votuesi tjetër, përveç përmbushjes së rrethanave nga paragrafi 5 i këtij neni."*, i cili mund të aplikohet *mutatis mutandis*, marrë parasysh se ka filluar procesi votues në diasporë. Gjithashtu, ka cenuar rëndë edhe dispozita të tjera ligjore të LZP.

Më datë 17.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 19.01.2025, Subjektin Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se përmes rrjetit social facebook, i'u është adresuar të gjithë anëtarëve aktivistëve dhe përkrahësve të Subjektit politik PDK, duke ju bere thirrje që të njëjtit gjatë kësaj periudhe kohore të fushatës zgjedhore të përdorin gjuhë të respektueshme të shmangin gjuhen nxitëse, fyese ose urrejtjeje si dhe të respektojnë ligjet dhe rregullat zgjedhore të cilat përveç se përbejnë detyrim ligjor është edhe me përgjegjësi morale që forcon demokracinë dhe ndërton themelet për suksesin e përbashkët.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK, ka bashkangjitur një fotografi të shkëputur nga rrejtji social facebook, e postuar më 17.01.2025, me përmbajtje të thirrjes së subjektit politik drejtuar aktivistëve dhe përkrahësve dhe të tyre.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga provat e paraqitura nga pala ankuese nuk mund të vërtetohet se behet fjale për personin e caktuar.

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli pas shikimit të bërë artikullit të ofruar si provë materiale CD, e cila është publikuar në rrjetin social Facebook dhe tik tok, prej nga shihet një person i cili në profilin e tij e ka postuar një video, ku shihet duke plotësuar fletëvotime nga diaspora për shumë persona, mirëpo duke qenë se në rastin konkret bëhet fjalë për një profil të caktuara në dy rrjetet sociale që për Panelin është vështirë të vërtetohet identiteti i sekt i personit në fjalë, pasi që lehtë mund të manipulohet apo të hapet një adrese në këto platforma me emër dhe mbiemër qoftë edhe të personit në fjalë duke qenë se bëhet fjalë për prova elektronike nga rrjetet sociale, e që nga këto materiale nuk mund të vërtetohet me një besueshmëri të lartë se behet fjalë për personin emri i të cilit është përmendur, se personi në fjalë është apo nuk është aktivist i subjektit politik PDK, po ashtu nga materiali i fotografive të publikuara në profilin e facebook-ut me emrin Besian Bucaliu, nuk mund të vërtetohet se i njëjti është simpatizant i PDK-së pasi që nga provat e çështjes rezulton se në një video shihet duke mbajtur fjalim Albin Kurti kandidati i LVV për Kryeministër ndërsa në materialet tjera shihen fotografite e politikanëve të më përparshëm. Paneli konsideron se në rastin konkret mund të ekzistojnë dyshime për elemente të veprës penale e cila mbetet të vërtetohet në procedurë përkatëse ligjore.

Rrjedhimisht edhe veprimet kryesore të përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.62/2025 më datë 20.01.2025

Kryesues i Panelit
Skender Qosaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.